



## BOOK OF ABSTRACTS

### Mapping Balkan routes: literary, cultural and linguistic landscapes

#### International Conference on Balkan Studies

organized by  
the Department of Foreign Languages and the Department of Albanian Language  
DQG/LMUDXUH)DFXOV RI +XP DQMH# QYHUV RI 9&UD ;,VP DQ HP DQ\$  
and the Faculty of Philology, University of Belgrade

8-9 September 2017, Vlorë, ALBANIA



## BOOK OF ABSTRACTS

### Mapping Balkan routes: literary, cultural and linguistic landscapes

#### International Conference on Balkan Studies

organized by  
the Department of Foreign Languages and the Department of Albanian Language  
DQG/LMUDXUH)DFXOV RI +XP DQMH# QYHUV RI 9&UD ;,VP DQ HP DQ\$  
and the Faculty of Philology, University of Belgrade

8-9 September 2017, Vlorë, ALBANIA

**Mapping Balkan routes:**  
literary, cultural and linguistic landscapes

**International Conference on Balkan Studies**

*Organized by the Department of Foreign Languages and the Department of  
Albanian Language and Literature, University of Vlora "Ismail Qemali"  
in collaboration with the Faculty of Philology, University of Belgrade*

**8-9 September 2017, Vlora, Albania**

**BOOK OF ABSTRACTS**

Mapping Balkan routes:  
literary, cultural and linguistic landscapes

International Conference on Balkan Studies

ISBN 978-9928-245-07-6

Printed by “Tryptik”, Vlora, Albania, 2017

## Table of Contents

|  |    |
|--|----|
| <b>Keynote speeches</b> .....                  | 5  |
| Mirjana Marinković .....                       | 5  |
| Shaban Sinani .....                            | 6  |
| <br>   |    |
| <b>Parallel sessions</b> .....                 | 7  |
| Cultural Studies .....                         | 7  |
| Comparative Literature .....                   | 20 |
| Literary Studies .....                         | 28 |
| Language and Literary Studies .....            | 38 |
| Linguistics .....                              | 43 |
| Lexicology/Semantics/Onomastics .....          | 53 |
| Didactics/Language Acquisition/Education ..... | 67 |



## KEYNOTE SPEECHES

**Mirjana MARINKOVIĆ,**

*University of Belgrade, Serbia*

**e-mail:** mirjana.marinkovic65@gmail.com

### **The Balkans from Rumelia to Southeastern Europe**

The speech aims to define the Balkans and its heritage as "a cemetery of different rulings and civilizations" (Isidora Sekulić), its historical identity shaped by encounters of the East and the West, Islam and Christianity, to underline the main fields of these encounters (material and spiritual culture, languages, literatures, music, folklore, mentality), to initiate the question if there is an authentic Balkan citizen and how many different and opposite identities he bears in himself, to recognize the Balkan area from the time it was called Rumelia (the European part of the Ottoman Empire) to the present time in which the term Southeastern Europe is preferred for some political and different other reasons. The speaker wants to raise the question why Balkan peoples try to escape from their Balkan identity and to give the vision of the Balkans as a region with a plenty of varieties and specific characteristics that make it a unique cultural and historical entirety.

**Keywords:** *Rumelia, Balkan identity, encounters*

**Shaban SINANI,**  
*Academy of Sciences, Albania*  
**e-mail:** shsinani1958@gmail.com

## **Disa vrojtime antropogjuhësore për ndërveprimin e shqipes me gjuhët në kontakt: rasti i serbishtes**

Marrëdhëniet e gjuhës shqipe me serbishten, në kuadër të ndikimit të sllavizmave në leksik e emërtime të përveçme, kanë një traditë të gjatë studimesh. Një mangësi e këtyre studimeve është përqendrimi kryesisht në aspektin sasior të rolit dhënës e marrës të dy gjuhëve në kontakt dhe funksionalizimi i të dhënave e përfundimeve kah prirjet etnocentriste. Në të kundërtën, vrojtimit antropogjuhësore mundësojnë që të vërehet prania e frymës së njëres gjuhë tek tjetra. Për këtë, marrin më shumë rëndësi rastet e bartjes së fjalës bashkë me kategorinë identifikuese etike të gjuhës së burimit; kalkimi i figurës në idiomatikë e paremiologji, prania e arkaizmave gjuhësorë në fjalë e shprehje formalisht të desemantizuara, shtegtimi i disa shkallëve tejet konservative në ligjërime (urime, mallkime, betime, bekime, vajtime), deri tek “kopjimi i gabimit” të gjuhës tjetër. Mundësitë që ofrohen në kërkim prej kapërcimit nga etnogjuhësia në antropogjuhësi janë metodologjikisht emancipuese.

**Fjalë-çelësa:** *antropogjuhësi, etnogjuhësi, gjuhë në kontakt, fjala dhe kategoritë etike, arkaizmat gjuhësorë, albanizmat në fjalën e figurshme, “kopjimi i gabimit”, fryma e gjuhës*

# PARALLEL SESSIONS

## CULTURAL STUDIES

**Roland ZISI,**

*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*

**e-mail:** rolandzisi@yahoo.com

### **Disa konkordanca ndërballkanike në trashëgiminë shpirtërore**

Në rajonin e Ballkanit jetojnë popuj me lashtësi antike, ose popuj paleoballkanas, dhe të tjerë të formuar më vonë. Në këtë rajon, ku popujt jetojnë “supi i njërit nën sjetull të tjetrit”, bashkëjetojnë dhe sot tre alfabetet: i latinishtes, i greqishtes dhe alfabeti cirilik. Karakteri multinacional, multigjuhësor, multialfabetik dhe multifetar ka krijuar përfytyrimin e shtrembër se në Ballkan nuk mund të ketë përbashkësi kulturore. Edhe sot ekziston dyshimi se Ballkani mund të ketë një të ardhme të mbështetur në parime themelore jetësore të njerëzimit se mund të ketë një Ballkan-Bibel. Përkundrazi, një Ballkan-Babel profetizohet shumë shpesh.

Kësaj prirjeje i kanë shërbyer edhe qendrimet etnocentriste në shkencë, që kanë mbitheksuar dallimin kundrejt përngjasimit, primatin kundrejt ndërveprimit, epërsinë kronologjike kundrejt vlerës shpirtërore.

Konkordancat ndërballkanike në trashëgiminë shpirtërore prekin jo vetëm atë që quhet “lidhje gjuhësore ballkanike”, por edhe korpuset kryesore të traditës gojore, eposin heroik dhe atë historik, ritet themelore të jetës, paremiologjinë, historinë politike dhe atë shoqërore, letërsinë dhe artet.

Ne do të ndalemi më së shumti në ciklin e betejës antiosmane të



Fushë-Kosovës, në zhvillimin sinkronik të disa dukurive letrare si romantizmi e letërsia sociale, dhe në disa dukuri të tjera, duke shkuar drejt përfundimit se më shumë se gjeneza e përbashkët, ka qenë fqinjësia historike ajo që ka ndikuar si faktor parësor për konkordancat ndërballkanike.

**Fjalë-çelësa:** *ballkanizma, albanizma, sllavizma, konkordanca, epi i betejës së Fushë-Kosovës, romantizmi në Ballkan, letërsia sociale*

**Naile MALA IMAMI,**

*University of Belgrade, Serbia*

**Olimbi VELAJ,**

*“Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Albania*

**e-mail:** olimbiolimbi@gmail.com

### **Initial interest of Serbian scholars in the Albanian population**

Në fillim të shekullit XX shkencëtarët serbë gjithnjë e më shumë filluan të interesohen për popullin shqiptar, historinë, folklorin dhe gjuhën e tij. Në studimin e Jovan Cvijiqit *Vendbanimet dhe prejaradhja e popullsisë*, u botua një material mjaft i çmuar etnografik lidhur me shqiptarët. Vëmendje të posaçme tërhoqi *Politika* e 21 majit të vitit 1924 kur në faqen e parë dhe të dytë e botoi artikullin e historianit Mita Kostiqit “Kelmendasit në Srem: dy fshatra të Sremit Nikinci dhe Hërtkovci të banuara me shqiptarë të cilët u vendosën në këto troje para 200 vjetësh, në kohën e patriarkut Arsenije Jovanoviqit”. Në vitin shkollor 1920-1921, në kuadër të seminarit të gramatikës krahasuese të gjuhëve indoevropiane, filloi të mësohej historia e gramatikës së gjuhës shqipe. Ky konsiderohet fillim i albanologjisë në Universitetin e Beogradit. Shumë shpejt pas kësaj filloi të botohej edhe revista *Arkivi për lashtësinë shqiptare*,

*gjuhën dhe etnografinë e gjuhës shqipe* (1923-1926), e para revistë e këtij lloji. Në fjalën hyrëse, të cilën e nënshkruan T. R. Gjorgjeviq dhe H. Bariq, thuhet se motivi për fillimin e botimit të kësaj reviste është “interesi i madh për shqyrtimin e së kaluarës, zakoneve dhe gjuhës së fqinjve tanë shqiptarë, historia e të cilëve gjatë shekujve ka qenë e lidhur mjaft ngushtë me historinë e popullit serb”. Në kuadër të edicionit të veçantë “Biblioteka e Arkivit për lashtësinë shqiptare, gjuhën dhe etnologjinë”, libri i parë ishte libri i Milan Shuflajt *Serbët dhe shqiptarët—Simbioza e tyre në mesjetë* (1925), me parathënie të historianit serb Stanoje Stanojeviqit. Ky libër u botua në gjuhën shqipe në vitin 1928, në Tiranë, të cilin e përkthyen Zefë Fekeçi dhe Karl Gurakuqi. Punimi synon të hedhë dritë mbi botimet e para shkencore nga autorë serbë nga ish-Jugosllavia në lidhje me popullin shqiptar.

**Fjalë-çelësa:** *shqiptarët, serbët, gjuha, kultura, lashtësia shqiptare, albanologjia, Arkivi, etnografia shqiptare*

### **Initial Interest of Serbian scholars in the Albanian population**

At the start of the 20th century, Serbian scholars began to show growing interest in the Albanians, their history, folklore, language, etc. In Jovan Cvijić's study *Settlement and origin of the population*, a material of significant ethnographic value for Albanians was published. Special attention was drawn when the daily magazine *Politika* published on 21 May 1924 on its first and second pages, an article of the historian Mita Kostić, “The Kelmendi tribe in Srem: two villages in the Srem district, Nikinci and Hrtkovci where the Albanian population settled 200 years ago, under the patriarch Arsenije Jovanović”. In the academic year 1920-1921, in the framework of the Seminar on Comparative Grammar of Indo-European languages, Albanian grammar studies were introduced.

This is considered to be the beginning of Albanian Studies at the University of Belgrade. Soon after this, a journal was published *Archive of Albanian antiquity, language, ethnography and language* (1923-1926), the first of its kind. In the introduction to the journal, which was signed by T. R. Gjorgjević and H. Barić, it was written that the motivation for starting the publication of this journal was “high interest in analysing the past, the customs and language of our neighbouring population, the Albanians, whose history through centuries was closely connected with the history of the Serbian population.” Within a special edition of *The Archive Library of Albanian antiquity, language and ethnology*, the first book was Milan Šufflay’s *Serbs and Albanians—Their Symbiosis in the Middle Ages* (1925) with an introduction by the Serbian historian Stanoje Stanojević. This book was published in the Albanian language in 1928 in Tirana and was translated by Zefë Fekeçi and Karl Gurakuqi. This article aims at presenting the first scholarly publications about the Albanian population by Serbian authors from former Yugoslavia.

**Keywords:** *Albanians, Serbs, language, culture, historical times, Albanian language studies, archive, ethnography*

**Vilma BELLO,**

*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*

**Alma BAKIU,**

*“Jani Minga” Secondary School, Vlorë, Albania*

**e-mail:** vilmabello2000@gmail.com

## **Roli i gjuhës në procesin e komunikimit ndërkulturor**

Tashmë është e qartë se gjuha është mjeti më i plotë dhe më kryesor që përdoret për komunikim në shoqërinë njerëzore, si dhe për sendërtimin e marrëdhënieve shoqërore. Nëpërmjet komunikimit

gjuhësor shoqëria arrin të krijojë marrëveshje, për realizimin e së cilave njerëzve u duhen aftësi komunikuese. Mes çështjeve të aftësive komunikuese, ajo çfarë do të dallonim në këtë punim janë elementet përshtatës të aftësisë komunikuese ndërmjet individëve me kultura të ndryshme. Situatat mund të jenë të ndryshme, por do përqendrohemi në dy raste: 1. *Komunikimi i dy individëve në gjuhë të huaj*. Në rastin kur komunikojnë dy individë në gjuhë të huaj ka të ngjarë të ndodhin keqkuptime, apo të krijohen situata konfliktësie më tepër se sa në rastin kur individët komunikojnë në gjuhën amtare. Problemet mund të shkaktohen nga shkalla e ndryshme e zotërimit të gjuhës që kanë zgjedhur të dy individët për të komunikuar me njëri-tjetrin. Kompetenca gjuhësore kërkon që njohuritë, të cilat zotëron individit në gjuhën e huaj përkatëse të jenë të tilla që individit të kuptojë dhe të prodhojë shënime gjuhësore, sidhe t'i përcaktojë ato në mënyrë korrekte:

2. *Komunikimi me dialekte të ndryshme*. Në Shqipëri ndodh jo rrallë që individët të cilët flasin dialektin e jugut të mos kuptohen, ose të keqkuptohen me individë që flasin dialektin e veriut ose anasjelltas. Edhe në rastin e komunikimit me dialekte të ndryshme rregullat gjuhësore të secilit dialekt përcaktojnë se si duhet të shqiptohen fjalët, si duhet të organizohen pjesët bazë të ligjëratës, ku duhet të vihen theksat etj. Veçanërisht fondi i leksikut, semiotika e fjalëve të caktuar, mënyra sesi formohet koha e ardhme e foljes etj. dallime si këto mund të sjellin keqkuptime në komunikim mes individëve nga dy dialektet e shqipes .

Konflikte që mund të shkaktohen nga komunikimi janë të shkallëve nga më të larmishmet. Krijimi i koncepteve të përbashkëta, megjithëse nxënësit ose studentët mund të vijnë nga kultura të ndryshme gjuhësore dhe sociale do ta lehtësonin komunikim kulturor dhe gjuhësor mes tyre dhe për rrjedhojë do të kishim më pak konflikte sociale.

Si përfundim duke qenë se gjuha është shfaqja më konkrete e jetës sonë mendore dhe si rrjedhojë një mjet i fortë për të kuptuar më mire

veten dhe shoqërinë duhet të theksojmë se është detyrë e mësuesit të gjuhës shqipe dhe më gjerë që të ndihmojë nxënësit në mënyrë që të mësojnë të realizojnë qartë kuptimin e fjalisë dhe mendimit të vërtetë , duke bërë të mundur shmangien e dykuptimisë, krijimin e përmasave të tjera kulturore, integrimin e grup nxënësve të veçantë në kulturën e qytetarisë, duke i modifikuar në botën e qytetarisë demokratike.

**Fjalë-çelësa:** *komunikim gjubësor, marrëdhënie shoqërore, gjuha, kulturë qytetare, dialekt, gjuhë e huaj*

**Albert HABAZAJ, Evis ÇELO,**  
*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*  
**e-mail:** bertbiblioteka@gmail.com; evis.celo8@gmail.com

### **Urat lidhëse midis thrakëve dhe ilirëve si hierarki e mozaikut të kulturave ballkanike**

Në këtë artikull, vertikalisht ngushtë, trajtojmë raportin e marrëdhënieve thrako - ilire, qysh nga antikiteti nëpër rrjedhat e kohës, parë nga harmonizimi i dy këndvështrimeve: në rrafshin e historisë së dy popujve dhe atë të antropologjisë kulturore.

Ndërkohë, ky punim është nismë për të vijuar punën studimore në rrafshin e marrëdhënieve të të parëve tanë me kufitarët e tyre, me fqinjët historikë, siç janë grekët, serbët, malazestë dhe popujt e tjerë të rajonit, si copëza shumëngjyrëshe etnokulturore, që zbukurojnë mozaikun e kulturave ballkanike dhe të popujve mesdhetarë, jo vetëm bardhë e zi apo, aq më keq, zi e zi. Ballkani, që përfshin vendet e Europës juglindore e që shtrihen në jug të lumenjve Danub e Drava, ndërmjet Detit Adriatik e Jon në Perëndim, Detit Egje dhe Detit të Zi në Lindje, dhe Detit Mesdhe në Jug, është atdheu i popujve të ndryshëm, që përfshijnë shqiptarët, grekët, serbët,

bullgarët, turqit dhe vllahët. Ballkani, një zonë gjeografikisht e afërt me Europën, është parë jo rrallë herë konceptualisht e largët, sidomos nga observuesit europianoperëndimorë të Ballkanit. Përdoret rëndom nga të tjerët cilësimi “fuçi baroti” për ne, ballkanasit dhe shtëpinë tonë të përbashkët, Ballkanin. Jo pak herë, vetë, ne banorët rinj të kësaj shtëpie të lashtë i kemi fryrë zjarrit për ta ndezur, jo për ta fikur flakën e urrejtjes “midis vedit”, përlshjes me njeri-tjetrin. Rikthimi tek tradita e bukur dhe e dobishme e “Udhës së Mëndafshit” në Ballkan, në udhëtakimin e Lindjes me Perëndimin, mund të bëhet një motiv produktiv për të shembur muret e ndarjes dhe urrejtjes e të ngremë urat e bashkëpunimit e harmonisë.

**Fjalë-çelësa:** antropologji kulturore, histori, kultura ballkanike, ilirë, thrakë, shqiptarë, bullgarë

**Bedri ZYBERAJ,**

*Independent scholar, Kosovo*

**e-mail:** bedrizyberaj@hotmail.com

### **“Të dënuar” për të qenë vëllezër në bashkëjetesë**

Kontradiktat mes shqiptarëve të Kosovës dhe shtetit të Serbisë si kapitulli i fundit i një ngatërrese rajonale. A ka argumente për parahistorinë e këtij konflikti? A kishte përpjekje për pengimin e saj? Personaliteti dhe vepra e Adem Demaçit: peripecitë dhe e kaluara e tij deri në kohën e jetësimit të pluralizmit. Filozofia e veprës së tij, thelbi dhe orgjina e saj. Vizioni dhe angazhimi i Demaçit për shmangjen e konflikteve. Raportet shqiptaro-serbe në optikën e kësaj filozofie. “Të dënuar” për të qenë jo armiq, por vëllezër. Harmoni dhe bashkëjetesë civile e kulturore. Mbizotërimi i filozofisë optimiste në këtë kontekst. Këto do të jenë disa nga

çështjet që mendoj se janë me rëndësi dhe që do të paraqesin esencën e këtij punimi eseistik, përmes të cilave do të përpiqem të ndriçoj disa aspekte të raporteve shqiptaro-serbe, që janë ndër më të rëndat dhe ndër më të ndërlikuarat në rajon.

**Fjalë-çelësa:** *falja, liria, robëria, shtypja, vëllavrasja, vuajtja, etj.*

**Armela PANAJOTI,**

*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*

**e-mail:** [armelap@assenglish.org](mailto:armelap@assenglish.org)

### **Mapping Balkan tourist routes: A semiotic reading**

In the last decade, the Balkans have become an inspiring destination for many overseas tourists. The need for developing tourism has, among other things, given way to the establishment of governmental and non-governmental entities in the Balkan countries, the national tourist agencies being but one example. One of their most widespread means for promoting tourism is launching promo videos to invite tourists from all over the world to visit their country.

In this paper, I discuss some of the latest promo videos produced by the national tourist agencies in the Western Balkan countries in order to identify their similarities and differences. For the purposes of this analysis, I will draw on the semiotics of sign systems in order to identify the codes that govern these videos, in an attempt to ‘map’ what in the title I call Balkan tourist routes. I will focus on the visual and linguistic contents of these videos in order to demonstrate that they communicate a reality—cultural, mental, semantic, linguistic—overall, representative of national identity (herein loosely defined as that which provides people sharing the same language, customs and culture with a sense of belonging),

but largely affected by internationalisation and globalization.

**Keywords:** *identity, semiotics, sign systems, internationalism, globalization*

**Julijana VUČO,**  
*University of Belgrade, Serbia*  
**e-mail:** [julivuco@gmail.com](mailto:julivuco@gmail.com)

### **Regional interuniversity collaboration and language needs**

In the recent years, universities have been playing an increased international role in the public life, and the internationalization of universities has become one of the most important goals of higher education. This phenomenon is reflected in the actions and attitudes of national and supranational institutions that plan and invest in a wide array of international exchange programmes. The command of language is one of the fundamental problems of involving students, participants of the mobility programmes in the teaching process in various environments. Languages in action are mostly English, a second foreign language subject and the local language of the host. On the one hand, there is a need to achieve necessary English language skills for teaching or learning, sometimes knowledge of a second foreign language, both with an explicit need for academic language competence for teaching and learning, scientific and professional needs and purposes. On the other hand, languages of the host countries are in the forefront, the needs for rapid language development in order that the experience of study visits abroad be successful both in the private and academic domains.

In this paper, results of research on the attitudes and needs of the functional quality of the language skills of students of the University of Belgrade, beneficiaries of incoming and outcoming



academic mobility are presented and analysed.

**Keywords:** *internationalization of universities, mobility, language competences*

**Serpil MURTEZAOĞLU,**

*Istanbul Technical University Turkish State Conservatory, Turkey*

**e-mail:** murtezaogl@itu.edu.tr

### **The changes of Romani music in Edirne in the context of intercultural effect and media influences**

Music is not only a cultural expression and an identity indicator amongst the Romani communities, but also a vital part of the way that they live their lives. Just as the many other Romani communities in Turkey, the Romani people in Edirne are also extremely gifted with music and although there are social and economic struggles that they are constantly faced with, they always find the way to centralise music and entertainment in their daily lives.

Generally speaking, children born in these kinds of communities are introduced to music at a very young age through the influence of their family. The most recognizable aspect of Edirne Romani music is that it has a 9/8 time signature.

Music generally represents joy and fun for the Romani people. Even though they have difficult lives, it is not likely to come across sad or depressing lyrics in verbal Romani Music. Rather, the lyrics have more of humorous and sarcastic vibes with lots of slang. Subjects are generally about love, missing lover, family relations, cheating, drinking and dance.

Lately with the influence of the media and the musical performances of the neighboring countries, there has been a change in the Romani music. Different performance styles are

affecting the Edirne Romani music. New sub-genres are emerging such as Techno-Roman. These new styles are being welcomed by the Romani youth. In some instances, a character from a local TV series can be found in the lyrics of the newly bred Romani music. In this report, the findings of a field study in Edirne will be explained and the current state of change in Edirne Romani music will be discussed.

**Keywords:** *Romani music, social changes, Edirne*

**Jovanka LAZAREVSKA-STANCEVSKA,**  
*Ss. Cyril and Methodius University, Skopje, Macedonia*  
**e-mail:** [jovanka@ukim.edu.mk](mailto:jovanka@ukim.edu.mk)

### **Language as a source of humour**

The paper tends to analyze jokes from a linguistic perspective and to describe and classify all the available linguistic devices for achieving humorous effects. First, it will focus on word formational processes that underlie jokes, such as prefixation, suffixation, compounding and clipping. Then, it will take into account different sense relations of words such as polysemy, homonymy, and antonymy that are source of humour. Metaphorical extensions will also be analysed as a creative way to achieve humorous effects. Finally, the analysis will focus on the different types of ambiguities which cause humorous effects, such as lexical, structural and scope ambiguity.

The analyses will be conducted on a corpus of jokes both in the English and the Macedonian languages.

Also, the aim of the research is to apply results in teaching sense relations and rhetorical tropes to the students of English.

**Keywords:** *humour, linguistic devices, word-formation, sense relations, ambiguity*

**Fjona ÇUKANI, Ledina MERKAJ, Iltana KOLEKA,**

*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*

**e-mail:** ledina\_merkaj@hotmail.com;

fjona2002@yahoo.it;

iltanakoleka@yahoo.com

### **Bridging cultures through tourism. A case study: Albanian tourist professional figures from a European perspective**

In this paper, through a case study conducted with tourist professional figures in the Albanian educational system, we aim at identifying what the Albanian tourist sector offers in the European market, and contrasting it with that of the European Framework as well as pointing to the changes needed to meet the European perspective.

Albania has a unique opportunity to differentiate itself from its neighbours and to avoid a crowded market with revenues and profits in decline. It should attempt to position itself as an attractive destination for tourists who seek a unique experience by visiting cultural and natural sites and places presented in a truly “authentic” way.

Tourism policies aim at creating an integrated perennial tourism model, with the main focus on the cultural—natural—coastal dimension, on developing tourist products, attractive and competitive tourist destinations, and promoting sustainable investments in tourism. The quality of services in the tourism sector should be improved significantly in line with international standards, which call for investment in human resources through training and enhanced skills. In this sector, a wide range of

professions operate (influenced only by the tourism segment and by the technological innovations which have brought changes in service delivery), which are directly linked but not only.

These professions are regulated by law. The newest figures in this sector are those of the “tourist guide” which suggest considerable improvement of the image and promotion of the country. Until today this link in the tourism chain in Albania was almost nonexistent, and in this situation, it was necessary to professionalize the figure of the guides.

To meet the European framework of the vocational educational system, more investments in human resources are needed, through training, study visits and exchange programmes with the European universities.

**Keywords:** *vocational system, tourism educational policies, authentic, training*

## COMPARATIVE LITERATURE

**Donard HASANI,**  
*University of Arts, Tirana, Albania*  
**e-mail:** nardhasani@gmail.com

### **Një vepër, dy dramatizime, dy faktorë censurimi: rasti i romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”**

Romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Ismail Kadarese ka qenë shumë atraktiv për skenën teatrale dhe kinemanë. Përveç filmit shqiptar me të njëjtin titull, kjo vepër njohu dhe një realizim kinematografik franko-italian. Ndërsa në teatrin shqiptar kjo vepër njohu gjashtë dramatizime, tre prej të cilëve jashtë Shqipërisë shtetërore: në Shkup, në Prizren dhe në Prishtinë. Për shkaqe të disiplinave të ndryshme që dallojnë teatrin nga letërsia, në të gjitha dramatizimet ka prekje të tekstit referencial, largim nga narracioni i autorit, shndërrim në mjete të tjera (joletrare dhe jogjuhësore) të shprehjes: skenografi, kostumografi, mizanskenë. Rasti në shqyrtim i referohet dramatizimit të P. Manit në teatrin e Prishtinës (vitet 1970) dhe ai i dramatizimit të S. Fankut në teatrin e Shkodrës (1981). Qëllimi është gjetja e një përgjigjeje për pyetjen se çfarë synonte kontrolli shtetëror në ish-Jugosllavi dhe çfarë synonte në Shqipëri, ku ndryshonin këto dy censura. Nga krahasimi del se censura në Shqipëri i ruhej kryesisht pacifizmit, heroit negativ në dritë pozitive, erudicionit të priftit, zbutjes së figurës së pushtuesit. Ndërsa në rastin e dramatizimit në Prishtinë censura veprroi për ta dekontekstualizuar veprën, duke e shkëputur nga realiteti shqiptar; për ta rikontekstualizuar atë sipas rrethanave historike në ish-Jugosllavi gjatë luftës antifashiste, çka çoi deri tek zëvendësimi i pushtuesit fashist me atë nazist, dhe më së fundi, për ta shndërruar

në një dramë universale, mbikohore, pa ndonjë lidhje të dukshme me botën shqiptare.

**Fjalë-çelësa:** *Ismail Kadare, dramatisim, censurë*

**Laura SMAQI,**

*Institute of Linguistics and Literature, Tirana, Albania*

**e-mail:** laurasmaqi@gmail.com

### **Nga balada shqiptare tek ajo ballkanike përmes I. Kadaresë dhe B. Mustafajt**

Balada e Kostandinit dhe Doruntinës është ndër më të njohurat, komentuarat, interpretuarat e krijimeve tona popullore. Quajtur ndryshe baladë e besës ose e fjalës së dhënë, ajo është konsideruar si një ndër shprehjet e përbërësve bazë të identitetit dhe kulturës sonë. Ky këndvështrim ka mbizotëruar dhe në rastet kur mbi krijimin popullor janë realizuar vepra në gjini të ndryshme; do të kemi në fokus veprat “Kush e solli Doruntinën” e Kadaresë, fillimisht si novelë dhe roman, më pas si pjesë teatrale në skenën e Teatrit Popullor dhe *Doruntine fille-soeur, une histoire pour opéra et théâtre dramatique* (“Doruntina motra-bijë, një histori për opera dhe teatër dramatik”) e B. Mustafajt.

“Doruntina” e Mustafajt është botuar në vitin 1997, si tekst dramatik, nga shtëpia botuese *Actes Sud*. E destinuar për një publik të huaj, drama paraprihet nga dy grupe paratekstesh (shkruar prej autorit). Në këto paratekste autori riinterpretton baladën shqiptare sipas një këndvështrimi personal, të ndryshëm nga kuptimi që i është dhënë në mjedisin shqiptar, dhe në veprën e lartpërmendur të Kadaresë, të njohur edhe prej publikut francez. Zhvendosja e kuptimit lidhet dhe me kumtin që përcillet në *Requiem in ballkanik*, një tekst i dytë teatral pas atij të “Doruntinës”, pjesë e të njëjtit botim,

në të cilin kalohet nga balada në fjalë, në tiparet e përgjithshme të baladave ballkanike. Nqs i gjithë teksti i parë dramatik, e sheh baladën jo më në aspektin e himnizimit të besës e të vlerës që ka për botën shqiptare, por si përpjekje për të dalë nga izolimi, duke mos e mbyllur veten brenda hapësirës së ngushtë ku secili ka lindur e jeton, teksti i dytë e cilëson izolimin si tipar ballkanik, përmes të cilit popujt mbyllen historikisht, jashtë kontakteve me të tjerët. Kjo është drama e vërtetë e Ballkanit sipas autorit.

**Fjalë-çelësa:** *Ismail Kadare, Besnik Mustafaj, dramatisim, Doruntina*

**Etjona HOXHA,**

*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*

**e-mail:** etjona\_hoxha@hotmail.com

**“Mjerimi me kthetrat e tij i pushton të gjitha” e Miroslav  
Kreža-s dhe “Vargjet e lira” të Migjenit: një vështtrim  
krahasues**

Poemti i Miroslav Kreža-s “Mjerimi me kthetrat e tij i pushton të gjitha” u botua në dhjetëvjetëshin e dytë të shekullit të kaluar. Kurse “Poema e mjerimit” e Migjenit u botua më 1936. Midis këtyre dy veprave mund të evidentohen prerje ndërtekstore disa shkallëshe: në titull, në karakterin protestues, në rrjedhën e përbashkët si letërsi sociale, në metrikë e vargëzim (duke përfshirë vargun e lirë dhe prozodinë), deri dhe në idiomatikë, në figurshmëri, në tekst e në kontekst. Krahasimi mes dy teksteve do të jetë në rrafsh tematologjik, në rrafshin e motiveve, në rrafshin e poetikave dhe në rrafshin e dukurisë letrare.

Duke tejkuluar konceptin e ndikimit dhe të “meritës kronologjike”, çështja shtrohet në formën e pyetjes nëse përafritë e dy poetëve dhe të dy poemave të tyre janë me karakter dyanësh apo kanë lidhje

traktative. Siç rezulton, si Krleža, ashtu dhe Migjeni, ndërlidheshin më shumë me traktatin e futuristëve, që himnizonin prishjen e vargëzimit, thyerjen e rimës dhe ritmit, prishjen e masës, mitin e qytetit dhe të industrisë. Përkundër këtij drejtimi, në Ballkanin adriatik ishte zhvilluar dhe një drejtim tjetër, kontrovers: zenitizmi, me frymën e tij antieuropiane, me mitizimin e kulturës fshatare, me idealizimin e epokës paraindustriale. Migjeni, në pikëpamje të poetikave, kishte orientim të përbashkët me Krleža-n dhe renditej në krah të kundërt me Fishtën.

**Fjalë-çelësa:** *Krleža, Migjeni, futuristë*

**Valbona GAÇE-AVDULLAJ,**  
*Center for Albanologic Studies, Tirana, Albania*  
**e-mail:** valbonagace@gmail.com

### **Qasje krahasuese midis Migjenit dhe Srečko Kosovel**

Qasja krahasuese si metodë analitike në studimet letrare shtron nevojën e njohjes së lidhjeve të afërisë përmes ndikimit të vetëdijshëm ose të pavetëdijshëm midis veprave, autorëve, traditave në kontekste dhe periudha të caktuara. Vendosja e veprave në një rrafsh të tillë studimor pyetëson, jo vetëm llojin e marrëdhënies që ndërtohet midis dy teksteve specifike dhe sa janë përfshirë te njëri-tjetri, por edhe raportet e krijuara në një kontekst me diskurse të tjerë. Në këtë prizëm i kemi vendosur dy autorët e njohur të dy letërsive ballkanike: Migjenin, si përfaqësues të letërsisë shqiptare dhe Srečko Kosovel, të letërsisë slovene, të cilët, nisur si nga faktet biografike ashtu edhe ato letrare krijojnë një prerje të habitshme ngjashmërie.

Migjeni (1911-1938) është cilësuar si poeti i modernitetit në letërsinë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit të XX, nga ana



tjetër Srečko Kosovel (1904-1926), i quajtur edhe Rimbaud sloven mbahet poeti i parë modern i letërsisë slovene. Të dy janë shfaqur në letërsinë e tyre kombëtare me frymën e re moderne të letrave dhe mendimit evropian duke iu kundërvënë traditës që, për arsye të ndryshme ishte e ngjashme për të dyja vendet: të dyja letërsitë vinin nga një traditë romantike, pa pasur mundësi të kalonin ndryshimet që letërsitë e tjera europiane kishin pasur në fund të shekullit XIX. Kjo ngjashmëri duket edhe në stilin kompleks të të dy autorëve, çka e përthyen me rryma të ndryshme letrare të shek të XX, duke mos e identifikuar përfundimisht me një rrymë të caktuar letrare. Të dy eksperimentuan edhe në aspektin gjuhësor, duke sjellë elemente inovativë. Edhe përsa i përket receptimit, të dy karakterizohen nga elementi i zbulimit dhe rizbulimit për lexuesit e tyre.

Kosovel u tërhoq dhe u nxit nga idetë revolucionare, çka ndikoi edhe në mendimin dhe frymën poetike të krijimeve të tij; për Migjenin dihet që ai nuk u identifikua me asnjë rrymë politike përfundimisht, por janë të njohura faktet biografike të simpatisë së tij ndaj rrymës të majtë. Të dy shkruan dhe botuan një pjesë të krijimtarisë në ngjallje të tyre, fokusuar më shumë në shtypin e kohës; botimi i përmbledhjeve për të dy është bërë vetëm pas vdekjes. Të dy vdiqën në moshë të re, Kosovel për shkak të ftohjes që i kaloi në meningjit dhe Migjeni, për shkak të ftohjes që i rezultoi në sëmundje të mushkërive.

A janë këto pikëprerje thjesht rastësore, rezultat i intuitës së mprehtë krijuese apo edhe i një ndikimi të kushtëzuar nga konteksti rajonal ballkanik?

**Fjalë-çelësa:** *krabasim, modernizëm, zbulim, komunikim, ndikim*

**Olimpia GARGANO,**  
*Université Nice Sophia Antipolis, France*  
**e-mail:** olimpia.gargano@yahoo.it

**A French bridge between Albanian and Slavic culture:  
Prosper Mérimée's oeuvre and its influence on Mary  
Shelley's Albanian short story**

In the field of Balkan Studies, the French writer and scholar Prosper Mérimée (1803-1870) is renowned for his *La Guzla ou Choix de poésies illyriques, recueillies dans la Dalmatie, la Bosnie, la Croatie et l'Herzégovine* (1827), a collection of allegedly old Balkan songs he published under a fictional name. In an age of successful literary hoaxes to which Macpherson's Ossian had paved the way, the pretended discovery of folk ballads from a still little known European area proved to be exciting not only to scholars but also to a larger public.

On the other hand, his contribution to the field of Albanian studies as well as to the spread of Albanian topics in European literature is much less known. These are precisely the objects of our proposal. Regarding the first point, in 1854 Mérimée reviewed for French readers Georg von Hahn's *Albanesische Studien* rather thoroughly (and sharply) in one of the most prestigious French literary magazines. As it appears, it was from this essay that the consul Auguste Dozon drew the word "chkipe", the French transliteration of the endonym "Shqiptar" he used in his seminal work *Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise* (1879).

The second aspect our proposal deals with concerns the influence Mérimée exerted on the creation of a short story by Mary Shelley, which is one of the first specimens of English gothic novels inspired from Albanian topics.

**Keywords:** *Albanian Studies, Comparative Literature, Imagology, Cultural Studies*

**Merima KRIJEZI,**  
*University of Belgrade, Serbia*  
**e-mail:** merima.krijezi@fil.bg.ac.rs

### **General characteristics of Old Serbian and Albanian Literature. Are there any linking points?**

This paper is dedicated to an analysis of general characteristics of old Serbian and Albanian literatures. Despite the fact that we are dealing with the written forms of literature of two peoples, which got their literacy in different centuries (The Slavs in the 9th century, whereas the first written document, officially excepted as such in the Albanian dates is from the 16th century), historical circumstances within which they developed and rose, have influenced the existence of some things in common, but in a larger number of cases, of different characteristics.

Our focus will be oriented towards the analyses of the phases of development of these two literatures, the authors, as creators and representatives of old literature, and the literary forms which characterized both literatures.

**Keywords:** *Old literature, Old Serbian literature, Old Albanian literature*

**Elonora HODAJ, Doriana KLOSI,**  
*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*  
**e-mail:** elonorahodaj@hotmail.com; dorianaklosi@gmail.com

### **Profiles of Albanianhood in the focus of British romantic lenses**

Unfortunately, due to various political, social and economic

reasons, Albanian culture, literature and history at large, have long been traced and written down by foreigners rather than Albanians. Although often labelled as a “mute” people who can not express themselves because of the disappearance of historical sources, for the sake of truth, there has always been a considerable collective memory among Albanian people which has quite frequently been used by prominent writers and albanologists. The prototype of the romantic poet, Lord Byron, and British albanologist, Edith Durham, are probably the two main credentials in their efforts to serve as spokespersons of the Albanian life in the early nineteenth and early twentieth century in the eyes of the civilized world.

The purpose of this paper is to present profiles of Albanianhood as recorded in the British romantic diary of Durham’s “The burden of the Balkans” held during her first lengthy expedition, on horseback and on foot, through the wilderness of southern and central Albania and the long poem by Lord Byron “Childe Harold’s Pilgrimage” - Canto II. What brings these two names together despite the century-long span of their literary creativity seems to be the fact that their life ideology was led by the cult of individual freedom and at the same time by the romantic conviction that it is not acceptable, not even in the nature of things that the world remain immobile. The perception of the Albanian world from these two perspectives has many converging points that do nothing but reinforce the truthfulness of both accounts although in two very different genres of literary writing. The featuring of these compliances remain within the scope of the present paper.

**Keywords:** *Albanianhood, romantic, hospitality, generosity, freedom*

## LITERARY STUDIES

**Dhurata SHEHRI,**  
*University of Tirana, Albania*  
**e-mail:** dhuratashehri@gmail.com

### **“Hartë” e letërsisë së Ballkanit në shqip në dhjetëvjeçarin e fundit**

Kumtesa mëton të analizojë praninë e letërsisë ballkanike në procesin letrar shqiptar të dhjetëvjeçarit të fundit. Sa (analiza sasiore) dhe si (analizë cilësore) përfaqësohet secila letërsi e ballkanit në botimet shqiptare? Cilët autorë, cilat vepra? A është bashkëkohore letërsia ballkanike e përkthyer në shqip, apo përkthimet prej kësaj letërsie priren nga klasikja? A vijnë përkthimet prej origjinalit apo prej gjuhëve të dyta? Dominon proza apo poezia? Cila letërsi ballkanike është më e përkthyer në shqip, në dhjetëvjeçarin e fundit? Analiza do të përqendohet edhe në krahasimin e letërsisë shqipe dhe letërsisë ballkanike të përkthyer në shqip në të njëjtën periudhë për të hetuar ngjashmëritë dhe dallimet në nivel të temave dominante, gjinive dominante, formacioneve stilistikore etj.

Kumtesa do të përpiqet t'i japë disa përgjigje këtyre pyetjeve duke u prirur të krijojë premisat për të ndërtuar një databazë të qarkullimit të letërsisë “fqinje” nëpër vendet e Ballkanit. Më shumë se një rezultat përfundimtar, ajo mbetet një ftesë për bashkëpunim në skicimin e një “harte” të rrugëtimit dhe marrëdhënieve të kontaktit të letërsive bashkëkohore ballkanike.

**Fjalë-çelësa:** *letërsi ballkanike, tema dominante, gjini dominante, formacione stilistikore*

**Olimbi VELAJ,**  
*“Aleksandër Moisiu” Universiteti, Durrës, Albania*  
**Naile MALA-IMAMI,**  
*University of Belgrade, Serbia*  
**e-mail:** olimbiolimbi@gmail.com

**Letërsi ballkanike, apo letërsi e shkruar nga autorë  
ballkanas**

Ky punim mëton të shqyrtojë për aq sa mundet idenë e një letërsie të gadishullit, term që prej dekadash njihet si Letërsi Ballkanike. Duke iu referuar ngjashmërive kulturore, të kaluarës së përbashkët historike nën pushtimin turk, por edhe duke iu referuar folklorit dhe përdorimit të motiveve folklorike në veprat e disa prej autorëve më të njohur ballkanas, punimi do të sjellë në vëmendje idenë e ekzistencës së një letërsie mbi një shtrat të përbashkët ballkanik.

Duke sjellë argumente pro dhe kundër, çështja e një letërsie ballkanike do të trajtohet në punim, sidomos lidhur me mënyrën se si autorët i qasen folklorit dhe se si ata arrijnë të bëhen të suksesshëm duke u bazuar në traditat dhe motivet popullore. Autorë si Kadare, Andriq, Kazanxaqis, etj, mbështeten mbi traditën dhe përmes një letërsie të tillë arrijnë të bëhen të suksesshëm në nivel botëror. Punimi do të marrë në shqyrtim edhe mënyrën se si e shohin fqinjën këta autorë në veprat e tyre, pa mundur të cekë në mënyrë shteruese këtë, por duke iu referuar disa krahasimeve të trajtimit të motiveve nga secili autor.

Një krahasim me letërsinë latino-amerikane, apo me atë skandinave do të zërë vend në punim, sidomos duke iu referuar modeleve të këtyre letërsive dhe receptimit e perceptimit të tyre edhe nga vetë vendasit, jo vetëm nga të huajt.

**Fjalë-çelësa:** *Letërsi ballkanike, Kadare, Andriq, Kazanxaqis, motive, folklor, model*

**Kastriot GJIKA,**  
*University of Tirana, Albania*  
**e-mail:** kastriot\_gjika@yahoo.it

### **Itineraret dhe destinacionet letrare - mundësi e perspektiva**

Shumë nga veprat më të famshme letrare dhe poetike, të vendosura në vende reale që lidhen me jetën e një autori ose me ngjarjet e personazhet në veprën e tij, munden të na ofrojnë një mënyrë origjinale të interpretimit të hapësirës. Ato mund të lejojnë që të “lexojmë” territorin dhe t’u japim kuptim vendeve në një kombinim të balancuar të peizazhit natyror, trashëgimisë kulturore dhe aktivitetit ekonomik.

Ideja e “parqeve letrare” apo e “destinacioneve dhe e itinerareve letrare” është tashmë një realitet në shumë prej vendeve me letërsi të zhvilluar. Në vendin tonë, për fat të keq, kjo ide ende nuk është realizuar.

Mjediset në të cilat vendosen romanet, tregimet, novelat ose poezitë—qofshin ato shtëpi, rrënoja, qytete historike, fshatra, lagje etj.—mund të bëhen burim i njohurive të reja mbi peizazhet dhe mjediset që janë pranuar si trashëgimi e veçantë. Ato mund të funksionojnë edhe si një dëshmitar i vlerave natyrore, historike dhe komuniteteve kulturore lokale, me synimin për t’i mbrojtur, ruajtur dhe rigjallëruar ato.

**Fjalë-çelësa:** *parqe letrare, trashëgimi, komunitete kulturore*

**Bardhosh GAÇE,**  
*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*  
**e-mail:** ketigace@hotmail.com

**Milan Shuflaj dhe vepra e tij “Serbët dhe Shqiptarët”**

Ndër studiuesit e talentuar evropianë që kanë hedhur dritë mbi marrëdhëniet e popujve të Ballkanit, historinë dhe kulturën e tyre mesjetare ka qenë edhe studiuesi kroat Milan Shuflaj, i cili së bashku me autorë ose vec, i ka bërë një shërbim të veçantë kulturës shqiptare. Qysh në fillim të shek. XX, ai tërhoqi vëmendjen e opinionit shkencor evropian me botimin e veprës “Akte dhe diploma” dhe më pas një varg artikujsh dhe studimesh mbi botën kulturore ilirike dhe arbërore. Në këtë hulli është edhe vepra e tij “Qytetet dhe kalatë e Shqipërisë kryesisht gjatë mesjetës” dhe punimet “Historia e Shqipërisë së Veriut”, si dhe “Serbët dhe Shqiptarët”, në të cilat krahas historisë së lashtë dhe të re të shqiptarëve nxjerr në dritë dhe mjaft doke e zakone, të cilat kanë një shtresë kulturore të veçantë të shqiptarëve, që kanë dhënë ndikimet e veta edhe në jetën e popujve të tjerë të Ballkanit. E kësaj natyre është edhe vepra e tij historike “Kostandin Balsha”, e cila ashtu si punimet e tjera të këtij dijetari mbart pasuri të mëdha të materialit burimor faktologjik. Në tërësi vepra shkencore e dijetarit Milan Shuflaji nxjerr në dritë etnitetin etnokulturor dhe rrënjët e lashta autoktone të shqiptarëve në rrjedhat e shekujve. Është një material i rëndësishëm, i cili jep me vizione të reja aftësitë rigjeneruese të shqiptarëve, por nga ana tjetër përcakton edhe mjaft elemente që kanë ndikuar në jetën e popujve të Ballkanit.

**Fjalë-çelësa:** *Shuflaj, etnokulturor, Ballkan*

**Ermir XHINDI,**

*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*

**e-mail:** *exhindi@gmail.com*

### **Arketipi ballkanik në një version shqiptar**

Për një kohë të gjatë, Ballkani, ky areal historik, gjeografik e



kulturor i paqëndrueshëm, heterogjen, armiqësor në përgjithësi me shqiptarët, është parë prej tyre si entitet i huaj, nga i cili, më së shumti ata janë shtrënguar të mbrohen. Në të njëjtën kohë, përmes një shqisë psiko-kulturore të jashtëzakonshme, që vetëm anas-it e kanë, shqiptarët kanë përkufizuar edhe një arketip ballkanik, të kryer sidomos në tekstet e Ismail Kadaresë. Ne kemi shqyrtuar pamjen strukturore e kuptimin e mundshëm të këtij arketipi sipas një matrice kuptimore bashkëkohore, në novelën *Sjellësi i fatkeqësisë*, të Ismail Kadaresë, një version surrealist brenda letërsisë së realizmit socialist. Megjithë prirjet e reja në letërsinë e viteve '90 e këtej, ky arketip vijon të zotërojë si tezë elitiste kulturën shqiptare. Puna është kuptuar si përpjekje për të shqiptuar qasjen shqiptare mbi idenditetin ballkanik sipas një praktike të lidhur me një model teorik Eko-Fish mbi leximin.

**Fjalë-çelësa:** *Arketipi ballkanik, modeli teorik Eko-Fish, Ismail Kadare*

### **The Albanian version of a Balkan Archetype**

For a long time, the Balkans, this unstable, heterogeneous, historical, geographical and cultural areal has been seen from the Albanians as a hostile entity, from which they have been generally forced to protect themselves. At the same time, through an exceptional psycho-cultural sense of *The Anas*, the Albanians have defined a Balkan Archetype, mostly shown in Ismail Kadare's works. We have examined the structural features and possible meaning of this archetype according to a Modern Meaning Matrix (MMM) in Ismail Kadare's novel *The Bringer of Misfortune*, a surrealist version of socio-realistic prose. Despite the new trends in Albanian literature from the early 90s, this archetype is still dominant as an elitist thesis in the Albanian culture. The paper is conceived as an attempt to articulate the Albanian view on Balkan Identity from

the perspective of the Eco-Fish theoretical model of the reading process.

**Keywords:** *Balkan Archetype, Eco-Fish theoretical model, Ismail Kadare*

**Mariglëna MEMINAJ,**  
*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*  
**e-mail:** mariglëna.meminaj@gmail.com

### **Empatia, simpatia dhe demonizimi i tjetrit në letërsinë ballkanase**

Profili i tjetrit në letërsinë ballkanase është i veçantë e i ndërlikuar, po aq sa ç'është përfytyrimi i tij në jetën reale përgjatë rrjedhës së historisë. Duke qenë se Ballkani ka qenë në vetvete një urë mes lindjes e perëndimit, duke qenë "tjetri" i Europës dhe njëkohësisht pjesë e saj, në letërsinë ballkanike konceptin e vetes e të tjetrit, e shohim të shprehur në formë specifike.

Në letërsinë ballkanase, ashtu si në perceptimin e popujve të Ballkanit, tjetri ka qenë i huaji, pushtuesi, që vinte ose nga një perandori e fuqishme, ose nga "përtej gardhit", fqinji, i ngjashmi, por edhe i ndryshmi njëkohësisht. Ai në shumicën e rasteve ka ushtruar të gjithë influencën e vet për të përhapur kulturën e tij dhe, edhe kur ka qenë pjesë e një perandorie, edhe kur ka qenë thjesht fqinj, ka bashkëjetuar me ta për një kohë të gjatë duke tentuar të zhbëjë tiparet e identitetit të tyre.

Për shkak të rrethanave specifike, një bashkëjetese shekullore, dhe një historie të përbashkët, profili i tjetrit në letërsinë ballkanase ka disa karakteristika që, përtej dallimeve e ndasive shekullore konflikteve të vjetra e të mprehta, ka po aq të përbashkëta në përfytyrim, ashtu siç ka të përbashkëta në kulturat dhe identitetet respektive.

Qëllimi i kumtesës është të tregojë identikitin e këtij tjetri ballkanik (nisur nga vepra të prozatorëve shqiptarë e serbë), i cili, në raportin me veten, është në pozicione të ndryshme e shpesh të kundërta: herë herë është demonizuar, empatizuar e madje simpatizuar dhe, ashtu si çdo gjë që lidhet me Ballkanin, vjen përmes ngjyrave e kontrasteve të forta, po thelbësisht të ngjashëm.

**Fjalë-çelësa:** *tjetri, vetja, Ballkan*

**Alta HALUCI,**

*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*

**e-mail:** [altahaluci@gmail.com](mailto:altahaluci@gmail.com)

### **“Tanusha e Krajlit” si simbol i bukurisë femërore në eposin shqiptar**

A kanë jetuar “n’mnì t’njani-tjetrit” gjithnjë përgjatë shekujve shqiptarë e sllavë? Eposi heroik legjendar shqiptar na jep një përgjigje. Heroi i dytë i eposit, Halili, që është konsideruar si shenjues i bukurisë mashkullore, kur Muji i kërkon të martohet, thotë se nuk do të marrë “tjetër çikë” për nuse veç “Tanushës së Krajlit”. Në tekstet shkollore Tanusha është paraqitur si simbol i bukurisë femërore shqiptare, megjithëse është “çikë krajlje”. Në epos “krushqit nuk janë aspak të ngrirë”. Në trajtesën tonë do të merremi kryesisht me epin “Martesa e Halilit”, duke bërë ndonjë krahasim me romanin “Krushqit janë të ngrirë” të Ismail Kadarese.

**Fjalë-çelësa:** *eposi, heroji, Tanusha*

**Edlira ÇERKEZI,**  
*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*  
**e-mail:** cerkezi.edlira@gmail.com

## **Metamorfoza zoomorfe në traditën gojore shqiptare. Lindja e jashtëzakonshme e fëmijëve të jashtëzakonshëm**

Motivi i lindjes së fëmijës në rrethana të jashtëzakonshme ka tërhequr vëmendjen e tregimtarit shqiptar dhe është shumë i përhapur në epikën gojore shqiptare. Ka shtrirje të gjerë, sidomos në prozën popullore, përkatësisht në përralla. Përkundër një shtrirjeje shumë të gjerë në prozën gojore, ky motiv haset vetëm në balada. Përrallat e këtij motivi bëjnë pjesë në tipin e përrallave mitike.

Në përrallat e tipit mitik, siç është dhe përralla mbi fëmijën e lindur në rrethana të jashtëzakonshme, asimilohet një material shumë i pasur me origjinë mitike dhe nga besimet e lashta popullore. Vjetërsia e tyre ndoshta i përket periudhave shumë të hershme, që mund të lidhet me kohën e lindjes së pronës private e të bashkësisë fisnore. Para së gjithash duhet të lidhet me besimet totemiste.

Motivi është i pranishëm te të gjithë popujt e botës, sepse jeta është universale, ashtu sikurse që pasja e trashëgimtarëve është kategori morale ndërkombëtare. Për këtë arsye edhe motivin e kemi të pranishëm në koleksionet më të njohura botërore të përrallave. Gjendet i botuar që në përmbledhjet e famshme të vëllezërve Grim me tregime e përralla evropiane të botuara në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Në përrallat shqiptare, që kanë shtrirje të gjerë, gjithëkombëtare dhe jo rajonale, vajza ose djali i lindur është i transformuar në gjarpër apo në ndonjë formë tjetër zoomorfe ose fitomorfe. Në të dy rastet kemi të bëjmë me dëshirën e prindërve, që nuk kanë fëmijë, të bëjnë që të kenë një vajzë ose një djalë, qoftë edhe në formë të jashtëzakonshme. Në përrallat e interpretuara të këtij

motivi kemi konstatuar se mbizotërojnë variantet që për synim kanë lindjen e djalit, ndërkaq ato të motivit me lindjen e vajzës janë shumë më të kufizuara.

**Fjalë-çelësa:** *metamorfoza zoomorfe, tradita gojore shqiptare, lindja*

**Hekuran HASANAJ,**  
*University of Tirana, Albania*  
**e-mail:** hhasanaj@yahoo.com

### **Konceptimi i tjetrit në traditën gojore shqiptare**

Në krye të herës pranojmë se konceptimi për Tjetrin vjen që nga antikiteti dhe kjo zë fill që kur Tjetri, pra: kultura e tij etiketohej si barbare. Thënë ndryshe mospranimi i tjetrit vjen si shenjë paragjykimi, por njëkohësisht e gjithë kjo kthehej si kriter vetëvlerësimi. Duke artikuluar që këtu ai merrte vlerën e të ndryshmit, të huajit, të armikut. Për më tepër, kur flitet për një lokalizim si Ballkani, vatërzimi bëhet akoma më i nxehtë. Duket sikur ka shumë “mure” dhe pak “ura” komunikimi mes brigjesh, por në një vështrim më të thellë kjo nuk qëndron. Tradicionalisht kultura shqiptare ka qenë e destinuar të bashkëjetojë me Tjetrin ndër shekuj: së pari, si sjellje politike në pozita mbrojtjeje të identitetit kombëtar e territorial dhe për rrjedhojë ta “pranojë” Atë dhe aspak si shenjë të kompleksit të inferioritetit e as si epërsi ekstreme.

Në traditën gojore shqiptare Tjetri nuk vjen vetëm si etni e huaj, por vjen edhe si e reja, si e panjohura (matanë detit). Tjetri vjen si i ndryshmi dhe jo detyrimisht si i kundërti (antagonisti, i huaji, armiku). Shkëmbimet e kulturave, marrëdhëniet njerëzore, pritshmëritë këtej dhe matanë detit, këtej dhe matanë maleve kapuar, më shumë respektohen sesa stigmatizohen edhe pse në

pamje të parë duket sikur jo. Paralelizmat në eposin legjendar, martesat e shumëdashuruara e të shumëdëshiruara për arsye aleancash mbijetese apo të zhvillimit, jetesa në terrene e kushte të ngjashme japin në të vërtetë panoramën e plotë të larushisë së Ballkanit të ndezur historikisht e kulturalisht.

Punimi ynë do mbajë si objekt studimi mënyrën e konceptimit të tjetrit në traditën gojore shqiptare në mënyrë të veçantë të “Martesa e Halilit” dhe “Kostandini e Doruntina”.

**Fjalë-çelësa:** *Ballkan, tjetri, paralele, huaji, i ndryshmi, e panjohura, e reja*

## LANGUAGE AND LITERARY STUDIES

**Matteo MANDALÀ,**  
*Università degli Studi di Palermo, Italy*  
**e-mail:** matteo.mandala@unipa.it

### **Një sinkretizëm ballkanik në mjediset arbëreshe: tradita e Shën Lazarit dhe miti i ringjalljes**

Në trevat arbërisht-folëse të Siçilisë është ende e gjallë tradita ungjillore e Shën Lazarit. Kremtohet natën që paraprin “të dielën e Palmave” e cila, sipas traditës fetare ortodokse, është një nga katër të dielat që i kushtohen kujtimit të të vdekurve. Në fakt, kemi të bëjmë me një sinkretizëm që ka lidhje me mitin e lashtë të “ringjalljes” së natyrës (në pranverë) dhe me mitin e fillimit. Në këtë kumtesë e mbështetur krejtësisht mbi dokumente të panjohura gjuhësore, në dorëshkrim dhe mbi materiale antropologjike dhe linguistike me prejardhje nga mjediset arbëreshe, rindërtohen këto dy mitet duke i kërkuar rrënjët në kohën e prehistorisë indoevropiane dhe duke i përshkruar përhapjen në hapësirën ballkanike.

**Fjalë-çelësa:** *sinkretizëm, mit, hapësirë ballkanike*

**Migena BALLA,**  
*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*  
**e-mail:** migena.balla@yahoo.com

### **Onomastikoni në veprën letrare të De Radës: Një problem i prekjes historike mesjetare të mërgatës arbëreshe me kulturën (pravo)slave**

Emërtimet e përveçme në veprën e De Radës, të karaktereve dhe

të ndërveprimit të tyre: onomastikoni në përgjithësi, na bën të ditur se bota arbëreshe u nda nga toka e të parëve prej një rajoni që kishte prejka historike-fqinjësore me kulturën sllave, në gjuhë e besim. Shumica e emrave të karaktereve të kësaj vepre kanë formën e emrave ungjillorë ose laikë që bekohen në pravosllavizëm: Milosao, Miloshin ( edhe Milo Shini), Radovan, Strazimir etj. Në mënyrë të veçantë, onomastikoni i De Radës e ruan këtë gjurmë historike-kulturore në kangjeljet e veprës “Rapsodi e një poemi arbëresh”. I njëjti fenomen shfaqet edhe në veprën e Gavril Darës, Zef Skiroit dhe Fr. Crispit-Glaviano. Përfytyrimi tradicional për vendin nga u shkëputën arbëreshët është lidhur kryesisht me afëritë dialektore me çamërishten dhe toskërishten jugore. Por, onomastikoni i De Radës vjen me pyetjen: ku u takuan arbëreshët me kulturën sllave dhe dialektin pravosllav të krishtërimit? Ne shkojmë drejt përfundimit se origjina e arbëreshve është nga hinterlandi verilindor.

**Fjalë-çelësa:** *onomastikoni, De Rada, pravosllavizëm*

**Gladiola DURMISHI (ELEZI),**  
*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*  
**e-mail:** gladiola.elezi@yahoo.it

### **Një vështrim i përgjithshëm mbi veçori gjuhësore të letërsisë arbëreshe**

Letërsia arbëreshe i pati filizat e saj jashtë dheut amë, aty ajo gjeti forcë dhe përparim për t’u zhvilluar edhe më tej. Një element mjaft i rëndësishëm është ruajtja e origjinës së tyre, e trullit nga vinin dhe e gjuhës me të cilën flisnin. Ruajtja e traditave dhe e zakoneve të arbëreshëve të Italisë është një hap i madh dhe i guximshëm në një vend të huaj. Gjuha arbëreshe është brumi i ekzistencës dhe i përcjelljes së kësaj ekzistence brez pas brezi, fjalë pas fjale.



Gjithçka ishte e pastër e zakonshme, edhe pse në vend të huaj në një gjuhë të huaj, arbëreshi nuk mundi të asimilohej, sepse rrënjët e tij ishin kaq të forta sa asgjë nuk i lëkundti dot.

Për ruajtjen e origjinalitetit të gjuhës tek arbëreshët e Italisë janë marrë shumë gjuhëtarë dhe studiues si E. Çabej e studiues të tjerë të shquar. Në mënyrë të veçantë studiuesit iu janë referuar të dhënave të të folmeve të arbëreshëve të Italisë, si dhe gjuhës së disa prej autorëve më kryesorë të letërsisë arbëreshe, sidomos veprave të Jeronim de Radës, J. Varibobës, të Gavril Darës së Ri etj.

Të folmet e arbëreshëve të Italisë paraqiten si një pjesë e vogël brenda një popullsie dhe populli të madh, por përsëri shohim një ruajtje të traditës dhe gjuhës së vjetër shqipe. Këto të folme, megjithëse kanë disa ndryshime nga të folmet e Shqipërisë, janë të folme të gjuhës shqipe: struktura gramatikore dhe fjalori i tyre janë po ato të gjuhës së vjetër shqipe, edhe pse mund të themi se është ndikuar mjaft nga italishtja, ajo e ka ruajtur fondin themelor të fjalëve të vjetra shqipe.

Me rëndësi është përcaktimi se të folmet e arbëreshëve të Italisë “kanë karakter arkaik, se ato ruajnë ende disa tipare të shqipes dhe arbërishtes së kohës së mesme, që me kalimin e kohës ose janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë, ose janë ruajtur pjesërisht, në ndonjë dialekt konservator, siç është çamërishtja” dhe përmenden disa nga tiparet arkaike të të folmeve arbëreshe në fushën e fonetikës, në format gramatikore dhe në konstruktet sintaksore.

Gjuha shqipe që flasin arbëreshët e Italisë paraqitet si një formë më vete, që nuk është plotësisht e njëjtë me asnjërin dialekt të shqipes në trojet kompakte ballkanike, prandaj edhe disa studiues e kanë quajtur atë si një dialekt të tretë të shqipes. Realisht, po të vështrojmë elementet strukturore dhe fonetike themelore të ligjëtimeve arbëreshe, rezulton se (ato i përkasin toskërishtes jugore, duke u përputhur më fort me disa dukuri konservative të çamërishtes e të labërishtes), po edhe në gjuhën e autorëve të

vjetër gegë, nga ana tjetër, ato ligjërime paraqesin edhe dukuri e tipare inovative, sidomos në fushën e leksikut. “Të folmet shqipe të ngulmimeve arbëreshe të Italisë përbëjnë një grup të folmesh, mjaft të afërta me njëra-tjetrën, tiparet kryesore të të cilave janë si ato të toskërishtes, prandaj u takon të përfshihen në atë dialekt”. Për të pasur një paraqitje relativisht të qartë e të sigurt të gjendjes gjuhësore të ligjërimeve arbëreshe në Itali, është e nevojshme të bëhen edhe disa shqyrtime jo vetëm të dallimeve të këtyre të folmeve nga njëra-tjetra, po edhe të mjaft lëkundjeve e ndikimeve jo gjithmonë të njëjta nga ambjenti rrethues. Problemin e gjendjes së të folmeve dhe atë të rrjedhës a zanafillës së ngulimeve arbëreshe duhet t’i shohim duke gërshetuar dëshmitë gjuhësore me të dhënat e historisë, të etnografisë dhe përgjithësisht të kulturës popullore arbëreshe e shqiptare.

**Fjalë-çelësa:** *veçori gjuhësore, ngulmim arbëresh, ligjërime arbëresh, formë gramatikore, konstrukt sintaksor, element strukturor, e folme arbëreshe*

**Frosina LONDO,**  
*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*  
**e-mail:** frosinalondo@yahoo.it

### **Një vështrim mbi romanet e ciklit të Horës të shkrimtarit Carmine Abate**

Në fillim të viteve ‘90, shoqëria italiane nisi të përballej me realitete të reja migruese të cilat sollën impakte të veçanta në shoqërinë italiane. Interesimi i shoqërisë italiane për botën e emigracionit u shtri në të gjitha fushat. Krahas shkrimeve të tipit antropologji e publicistikë filloi të spikaste një tendencë e re shkrimesh nga autorë migrantë të cilët filluan të shpalosnin me punën e tyre nevojën për dialog e përballje kulturore. Në këtë periudhë

shkrimtari arbëresh Karmine Abate ishte kthyer, pas një emigrimi shumë vjeçar, nga Gjermania dhe ishte vendosur në Bezenelo, në Trentino, ku punonte si mësues. Të shkruarit ishte kthyer tashmë në angazhim e pasion për shkrimtarin. Si një studiues i vëmendshëm i të shkuarës dhe vrojtues i së ardhmes Abate i jep jetë pesë romaneve të ciklit të Horës, ku trajton me temat e mëdha të Jugut të Italisë, një vështrim shoqëror të problemeve të njerëzve që jetojnë në një vend si Kalabria, një krahinë periferike e Italisë. E gjithë veprimtaria letrare e Abates përqëndrohet në temën e emigrimit. Në këtë punim do të ndalemi në në pesë romanet e tij të parë, thënë ndryshe cikli i Horës.

**Fjalë-çelësa:** *Carmine Abate, cikli i Horës, rrëfim, emigracion, kulturë arbëreshe*

## LINGUISTICS

**Francesco ALTIMARI,**

*Università degli Studi di Calabria, Italy*

**e-mail:** franco.altimari@gmail.com

### **Udhëtime gjuhësore në hapësirën shumëgjuhëshe italo-ballkanike nëpër rrugët e gjellëve arbëreshe**

Autori merret në këtë kumtesë me analizën e disa leksemave që janë rezultat i kontakteve të shumta dhe të ndërsjellta gjuhësore që regjistrohen sidomos në leksikun e përbashkët të gjellëve—ushqimore dhe rituale—ndër gjuhët e hapësirës së përbashkët italo-ballkanike, duke analizuar një sërë huazimesh (sllave, greke, turke, etj.) që gjejmë në të folmet arbëreshe të Italisë. Ndër to veçohet fjala me origjinë sllave **kulaç** që gjejmë sot jo vetëm në këtë fazë më të vjetër të shqipes ballkanike të ‘eksportuar’ që prej shekullit XV në Itali me emigrimin e arbëreshëve, por edhe në gjuhët e afërta të arbërishtes, dikur në gadishullin ballkanik dhe sot në gadishullin italian.

**Fjalë-çelësa:** *huazime, ndikime, leksema*

**Genc LAFE,**

*University of Salento, Italy*

**e-mail:** gentius@hotmail.com

### **Përkimet gjuhësore shqiptaro-rumune si fryt i dinamikave të kontaktit gjuhësor ndërmjet parashqipes dhe latinishtes ballkanike**

Përkimet gjuhësore të shqipes me rumanishten përbëjnë thelbin

e lidhjes gjuhësore ballkanike. Ato prej kohësh kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve europianë dhe, më pas, të atyre rumunë e shqiptarë. Për të shpjeguar përkimet gjuhësore ndërmjet shqipes dhe rumanishtes, të cilat shtrihen në fonetikë, morfosintaksë dhe leksik, janë formuluar (më shumë nga gjuhëtarët rumunë) hipoteza të ndryshme mbi një prejardhje nga një substrat i lashtë i përbashkët, hipoteza të cilat për shkak të mënyrës së shqyrtimit të problematikës dhe të postulatit dogmatik të autoktonisë së padiskutueshme mbi të cilin mbështeten, nuk kanë sjellë dhe nuk mund të shpien në përfundime të pranueshme shkencërisht.

Në këtë kumesë do të trajtojmë një qasje të re, të parashtruar së pari nga albanologu dhe ballkanologu austriak Stefan Schumacher, sipas së cilës përkimet e shumanshme ndërmjet shqipes dhe rumanishtes janë fryt i një kontakti gjuhësor mjaft intensiv dhe të shtrirë në kohë ndërmjet parashqipes dhe latinishtes ballkanike, ku tipare të tilla si prapavendosja e njëjës shquese janë rezultat i ndikimit të parashqipes në latinishten ballkanike dhe fjalët e përbashkëta ndërmjet dy gjuhëve janë si rregull huazime nga (para)shqipja, ku ato shfaqen në familje fjalësh, në latinishten ballkanike, përkatësisht rumanishten, ku këto fjalë shfaqen të veçuara. Një gjykim i tillë i kthjellët, i pakushtëzuar nga argumente jashtëgjuhësore dhe i mbështetur vetëm në faktet gjuhësore, ofron një shpjegim të plotë dhe shterues të thelbit të lidhjeve gjuhësore shqiptaro-rumune.

***Fjalë-çelësa:*** *përkime gjuhësore, (para)shqipe, substrat, latinishte ballkanike*

**Nonda VARFI,**  
*University of Tirana, Albania*  
**e-mail:** [n\\_varfi@hotmail.com](mailto:n_varfi@hotmail.com)

## **Gjuhët e Ballkanit dhe format e tyre të brendshme**

Gjuhët japin dhe marrin me njëra-tjetrën. Këto marrëdhënie në

shumicën e rasteve kufizohen vetëm te ndikimet leksikore, d.m.th., te huazimet. Tashmë në këtë lëmë janë bërë shumë studime, por a janë të mjaftueshme? Mendojmë që studimet gjuhësore të thellohen më tej për të vërejtur ndikime të tjera që lidhen me të gjitha marrëdhëniet historike, kulturore, etnologjike të popujve të Ballkanit. Kjo kumtesë ngrihet si hipotezë për të ngjallur debat.

**Fjalë-çelësa:** *gjuhët e Ballkanit, ndikime, marrëdhënie*

**Marija Popović,**  
*University of Belgrade, Serbia*  
**e-mail:** marijapopovic.mps@gmail.com

### **Krahasimi i dygjuhësive në Serbi, me theks të veçantë në dygjuhësinë midis shqipes dhe serbishtes**

Në këtë punim do të flitet për dygjuhësinë serbisht - shqip dhe krahasimin e kësaj dygjuhësie me shembujt e dygjuhësive të tjera në Serbi. Për shkak se dygjuhësia serbisht – shqip është e pandashme nga konteksti në të cilin ekziston, ne do ta shqyrtojmë përmes prizmës së ngjarjeve politike dhe konflikteve të cilat kanë ndodhur në Ballkan në disa dekada të fundit. Në periudhën e RSFJ-së serbokroatishtja ka qenë gjuhë dominante në të gjitha republikat e shtetit, pa e marrë parasysh gjuhën amtare të qytetarëve të saj, pra për këtë arsye u zhvillua dygjuhësia e serbokroatishtes dhe e gjuhëve të tjera në RSFJ (duke përfshirë këtu dhe dygjuhësinë midis serbishtes dhe shqipes). Pas shkatërimit të Jugosllavisë kjo situatë dukshëm ndryshoi, u zvogëluar popullariteti i gjuhës dikur dominante, por edhe dygjuhësitë midis gjuhëve të kombeve të republikave të cilat ishin në përbërjen e saj. Përsa i përket situatës së sotme, në territorin e Republikës së Serbisë ende bashkëjetojnë anëtarët e grupeve të ndryshme etnike të cilët i flasin gjuhët e

ndryshme si L1: hungarisht, rumanisht, bullgarisht, etj. Njëra nga veçoritë e rëndësishme gjuhësore e këtyre grupeve është dygjuhësia pak a shumë e baraspeshuar në gjuhën e tyre amtare dhe në gjuhën serbe. Punimi synon të hedhë dritë mbi situata të ndryshme në të cilat zhvillohej kjo dygjuhësi dhe t'i shqyrtojë kontekstet e ndryshme në të cilat ekziston edhe sot.

**Fjalë-çelësa:** *dygjuhësia, kontaktet midis gjuhëve, konflikti midis gjuhëve, shqipja, serbokroatishtja, serbishtja*

**Elira XHAKOLLARI, Nexhip MËRKURI,**  
*University of Vlora "Ismael Qemali", Albania*  
**e-mail:** nexhip\_merkuri@yahoo.fr

### **Tiparet e interpretueshme të sintagmës emërore (SN) tek fjalët e urta të Ballkanit**

Ndërtimi i mesazheve nga breza të ndryshëm në ndarjen gjeografike gjuhë të Ballkanit këndvështrohet për tiparet e interpretueshme të sintagmës emërore(SN). Krahasimi realizohet në gjuhët: rumanisht, bullgarisht, maqedonisht, serbo-kroatisht si ndërtime shumë shekullore duke zgjedhur një kampion për të gjitha gjuhët (mbi 40 fjalë të urta të madhësive: fjali e thjeshtë, periudhë). Pasqyrohet më tej duke u mbështetur në programin minimalist apo standard të rishikuar të Chomsky-t (2005:62).

Tiparet semantike të secilës gjuhë të marrë në krahasim janë universale, ndërsa leksemat e ndryshme si ndërtuese të sintagmës emërore ndryshojnë nga njëra gjuhë tek tjetra duke shfaqur kështu edhe risitë, prirjet gjuhësore që bashkësia gjuhësore ka kultivuar në bazë të rrethanave të ndryshme historike. Afërsia gjeografike ka sjellë edhe afri, huazim dhe risi të dallueshme për kokën e sintagmës emërore dhe përcaktuesit e saj apo komplimentit. Mëshohet në

modelin e Gramatikës Universale të “Parimeve dhe parametrave”. Vendoset në këto gjuhë të marra për krahasim parametri kokë në llojet e lidhjes tek sintagma emërore. Argumentohet më tej theksimi në gramatikën gjenerative se sot priret nga ideja se rendi i elementeve në sintagmën emërore, qoftë rrjedhim i një zgjedhjeje parametrrike të kokës së sintagmës nuk ka të bëjë me njësitë më të mëdha se sintagma e as me ndërfaqësin semantik, por me ndërfaqësin fonetik. Rendi kokë sintagme - komplement ose e ndërsjellta është strukturë dhe jo thjesht çift linear. Veçoritë e secilës gjuhë kërkojnë që rendi linear që paraqet ndërfaqësi fonetik përcakton radhën e komplimentit dhe formon prirjen. Të parat e intepretueshme dhe të paintepretueshme shpërndahen në mënyra të ndryshme tek sintagma emërore (SN) pasi nuk kanë të njëjtën vlerë tek gjuhët e marra për krahasim.

Përbërësi fonologjik ka një raport me përbërësit e tjerë gramatikorë tek secila gjuhë. Ky raport ka të bëjë me njësi të brendshme mendore, por dhe me njësi të jashtme antotomo-fiziologjike.

**Fjalë-çelësa:** *sintagmë emërore, gramatikë universale, gramatikë gjenerative*

**Bukuroshe ISUFAJ,**

*University of Vlora “Ismail Qemali”, Albania*

**e-mail:** bukuroshe\_isufaj@yahoo.it

### **Roli i shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike**

Debati për ndikimin e shqipes në gjuhët e tjera të përdorura në Ballkan janë të kahershme.

Lidhur me rolin e shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike janë vënë re dy qëndrime a teori kontradiktore, një teori e parë dhe më e vjetër, që e pranon ndikimin e shqipes a



të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike dhe një teori e dytë e mëvonshme, që e mohon mundësinë e ndikimit të shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike. Gjatë shqyrtimit të dukurive të përbashkëta gjuhësore ballkanike, përfshirë këtu edhe historinë e formimit të tyre, na është krijuar bindja se studiuesit e derisotëm nuk kanë pasur gjithmonë sa dhe si duhet parasysh shtrirjen gjeografike dhe vjetërsinë e këtyre dukurive në shqipe. Dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike në shqipe grupohen: në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen në mbarë shqipen dhe në dukuri gjuhësore ballkanike që shtrihen vetëm në dialektin e jugut ose toskërishte. Vështrimi i tyre më për së afërmi na duket se flet për një vjetërsi dhe shtrirje më të madhe të tyre në shqipe, çka na shtyn të mendojmë për valë që kanë ardhur nga vise perëndimore ose nga një zonë që e ka pasur qendrën diku në territoret shqiptare e maqedone perëndimore dhe greke veriore. Kjo gjen mbështetje edhe në kushtet historike, në situatën etnike dhe në rolin e elementit etnik shqiptar në këto territore.

**Fjalë-çelësa:** *Ballkan, gjuba shqipe, dukuri gjuhësore, ndikim, element gjuhësor*

**Ksenija AYKUT,**  
*University of Belgrade, Serbia*  
**e-mail:** aksenija@ptt.rs

### **Turcizmi u nazivima balkanskih muzičkih instrumenata**

Balkan kao geografski prostor viševjekovnog suživota različitih naroda, iznedrio je specifični jedinstveni mentalitet i kulturne osobenosti koje se uočavaju u mnogim oblastima njihovog kulturnog i umetničkog života. Jedna od značajnih sfera u kojoj se kako u tradiciji tako i danas, osećaju međusobni uticaji i zajednički

elementi je muzika, posebno muzički instrumenti, korišćeni tokom dugog vremenskog perioda na zajedničkom kulturnom prostoru, pod različitim nazivima i njihovim varijantama prilagođenim jezicima naroda balkanskog prostora. Na polju narodne muzike i instrumenata balkanskih naroda zabeležen je značajan orijentalni uticaj. On se može istraživati sa više aspekata. Lingvistički pristup omogućuje utvrđivanje sličnosti u terminima korišćenim u balkanskoj muzici i u tom smislu stepen zastupljenosti turcizama koji se koriste u nazivima tradicionalnih muzičkih instrumenata balkanskih naroda. U ovom procesu treba poći od generalno najčešćeg naziva za narodni muzički instrument na Balkanu. U pitanju je reč čalgija, nastala od turskog çalgı. Zatim se prelazi na mnogobrojne nazive instrumenata, delova instrumenata i pribora koji se koristi prilikom izvođenja na njima. Preplitanje zvukova i melodija koje oni proizvode predstavlja izraz zajedničke muzičke tradicije.

**Ključne reči:** *turcizmi, balkanski muzički instrumenti, narodni instrumenti*

**Panajotis ASIMOPULOS,**  
*Hellenic Army Academy, Vari, Greece*  
**e-mail:** asimopoulosp@yahoo.gr

### **Воће и поврће у српским и грчким фразеологизмима**

На основу конструктивних друштвеноисторијских контаката и полиедарског културног синкретизма српски и савремени грчки језик у свакодневној комуникацији представљају значајан број лексичких јединица које означавају различите врсте воћа и поврћа. Паралелно те међујезичке манифестације јављају се дијахронично у много ширем контексту метафоричких слика, сложених конструкција и устаљењих фразеолошких израза.

Корпус је ексерпиран из семасиолошких и ономасиолошких, општих и фразеолошких, једнојезичних и двојезичних речника. Циљ овог рада је контрастивно описивање фразеологизама који садрже називе воћа и поврћа, указивање на њихове подударајуће тачке и главне диференције са семантичког становишта. Осим тога утврђују се еквивалентна семантичка поља у којим су заступљене карактеристичне димензије истражених компонената. Као методолошки оквир у раду је коришћена билатерална метода системско-функционалног поређења, односно контрастивна анализа, и то посматрана интерлингвално, при чему је полазни језик српски, а циљни језик грчки.

**Кључне речи:** *фразеологизам, воће, поврће, српски, грчки*

**Bledar TOSKA,**

*University of Vlora "Ismail Qemali", Albania*

**e-mail:** [bledartoska@yahoo.co.uk](mailto:bledartoska@yahoo.co.uk); [bledar.toska@univlora.edu.al](mailto:bledar.toska@univlora.edu.al)

### **Metaphorical aspects in Balkan media discourse**

This short talk aims at exploring one of the most important rhetorical tropes in media discourse, metaphor (expression). The focus is the study of cognitive metaphorical expressions and the construal of particular discourses for persuasive ends in Balkan media discourse, as a specific and common subgenre of media discourse. I intend to discuss how these tropes can be intentionally employed to affect readership's perception of arguments in media texts and help authors forward elements of argumentative plausibility in them. Various metaphorical expressions from different source domains are analysed to investigate this frequent rhetorical tool. The analyses are instantiated with different

examples and supported with comments and remarks highlighting the omnipresence and significant use of metaphorical expressions for persuasive ends in Balkan media discourse.

**Keywords:** *metaphor, Balkans, media discourse, arguments*

**Irena PAPPINGJI,**

*“Logos” University College, Tirana, Albania*

